



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.09.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 10 dhe 11 shtator 2019
2. Miratimi i programit të punës së komisionit 30 shtator – 18 tetor 2019
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi European-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE), nr. 168/2007”
4. Projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”
6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Ralf Gjoni, Evis Kushi, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shamenti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Reme Lala, Alket Hyseni

Mungojnë:

Ervin Bushati, Eglandina Gjermani, Rudina Hajdari, Taulant Balla

Të ftuar:

Fjoralba Caka- Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja- Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

Erjon Luci- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Anuela Ristani- Nënkryetare e Bashkisë Tiranë

Ilda Qazimllari- Përgjegjëse e Sektorit të Zbatimit dhe Marrëdhënieve Ligjore e Financiare në Drejtorinë e Implementimit të Investimeve të Huaja në Bashkinë e Tiranës

Tedi Bushaj- Përfaqësues i Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë

Belinda Ikonimi- Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi- Përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Para se të fillojmë me rendin e ditës më lejoni që në emër të të gjithë kolegëve t’i uroj deputetes më të re të komisionit tonë, zonjushës Reme Lala ditëlindjen: Edhe 100!

Fillojmë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 10 dhe 11 shtator. Kush është dakord me procesverbalet?

Miratohen.

Besoj se të gjithë keni pasur rastin të njiheni me programin e punës së komisionit për priudhën 30 shtator 18 tetor. Për të gjithë ata që nuk janë informuar, bazuar në kërkesën e përbashkët dhe propozimin që patëm herën e fundit në lidhje me thirrjen e ministrit në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Cakaj, po ju njoftoj se kjo kërkesë është nisur nga Kuvendi në datën 13 shtator. Unë kam folur me ministrin, ai ka pasur një axhendë të ngarkuar shumë ditë në sesionin e radhës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Në momentin më të parë, që axhenda e tij do ta lejojë, do ta kemi ministrin prezent për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që ne kemi paraqitur në kërkesën tonë të fundit.

A keni ndonjë gjë për të shtuar për programin e punës së komisionit deri në datën 13 tetor?

Miratohet.

Vazhdojmë diskutimin për 4 projektligjet që na kanë ardhur.

Fillojmë me projektligjin e parë: “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim- Asociimit, Shqipëri- Bashkimi European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë vëzhguesit në punët e Agjencisë së Bashkimit European për të drejtat themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrje në kuadrin e rregullores së Këshillit nr. 163/2007”. Relatore do të jetë kolegja Gjebrea, meqë kolegja Hysi për momentin është në një angazhim tjetër me Kryetarin e Kuvendit.

Të ftuar kemi zëvendësministren e Drejtësisë, Fjoralba Caka, e cila për momentin është në aktivitet me Kryetarin e Kuvendit, prandaj do të vijë pak më vonë, dhe zotin Besmir Beja, drejtor i Kualifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Zoti Beja, fjala për ju.

Besmir Beja – Faleminderit!

Nëpërmjet këtij projektligji Ministria e Drejtësisë propozon ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Shqipëria bën pjesë me statusin e vëzhguesit në Agjencinë e të Drejtave Themelore, e cila është qendra e ekspertizës për të drejtat themelore dhe është e decentralizuar. Kjo agjenci është krijuar për të ofruar këshilla ekspertësh dhe ekspertizë pranë institucioneve të BE-së ndaj shteteve anëtare për një sërë çështjesh në fushën e veprimtarisë së tyre. Në këtë kuadër nga pjesëmarrja Shqipëria mund të përfitojë asistencë teknike, veçanërisht në kapitullin 23 dhe përafrimin e legjislacionit në kuadër të procesit të integritetit evropian, si edhe të përfitojë të dhëna, modele statistikore të ndryshme të krahasueshme për vendet e tjera që janë pjesë e agjencisë, duke marrë në konsideratë që me statusin e vëzhguesit janë edhe dy vende të rajonit, Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Pra, është një instrument i mirë që ndihmon si Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të rolit që luan në bazë të kapitullit 23 për mbrojtjen e të drejtave themelore, si edhe përafrimin me Bashkimin Evropian në këtë fushë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli- Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit!

Ashtu siç u theksua, ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, e cila mundëson pjesëmarrjen e Shqipërisë në cilësinë e vëzhguesit në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

E rëndësishme është që mundëson asistencë dhe ekspertizë lidhur me të drejtat themelore tek organet, zyrat dhe agjencitë e komunitetit nga shtetet anëtare gjatë zbatimit të të drejtave komunitare, gjatë marrjes së masave ose përcaktimit të veprimeve brenda kompetencave të tyre për të respektuar të drejtat themelore.

Siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit, Bashkimi Evropian do të emërojë një vëzhgues dhe një zëvendës vëzhgues në bordin e menaxhimit të agjencisë, e cila do të marrë pjesë në punën e bordit të menaxhimit me të njëjta të drejta si anëtarët dhe zëvendësanëtarët të emëruar nga shtetet anëtare, por pa të drejtë vote. Ministria e Drejtësisë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji. Po ashtu Shqipëria do të kontribuojë me 160

mijë euro në vit, pra me një rritje të lehtë nga viti 2019 dhe më pas të shpresojmë që në vitet në vijim të kemi një rritje më të madhe.

Në fakt, bazuar në marrëveshjen IPA-2 me mbështetje për pjesëmarrje në programet e BE-së, ku edhe është parashikuar kontributi i përfituesit dhe kontributi i BE-së për secilën nga programet e BE-së, 80% e shumës mbulohet nga IPA, nëpërmjet rimbursimit në dy vjetët e ardhshëm pas kryerjes së pagesës, dhe pjesa tjetër 20% është kontribut i shtetit shqiptar.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Duke mbajtur në vëmendje se zbatimi i këtij projektligji do të ndikojë pozitivisht në kuadër të përshpejtimit edhe të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në BE, ftoj komisionin ta votojë dhe ta miratojë projektligjin!

Mimi Kodheli- Faleminderit!

Kalojmë te pyetjet dhe diskutimet.

Po, zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Faleminderit!

Ky projektligj që diskutojmë sot e ka zanafillën që në vitin 2013 dhe kusht formal është statusi i vendit kandidat. Vendimin e kemi marrë në Këshillin e Stabilizim Asociimit në vitin 2018, fillimisht në komitet dhe pastaj në Këshill.

Unë ju dëgjova me shumë vëmendje. Edhe për shkak se dikur kam qenë drejtor i përafrimit dhe legjislacionit më duket se e trajtoni përafrimin e legjislacionit si një gjuhë të huaj të vështirë. Unë dua të di: a keni një plan pune si do të shfrytëzojmë praninë tonë në këtë agjenci?

E dëgjova edhe kolegen time që bëri ndarjen e fondeve që do të dalin nga taksapaguesit europianë dhe fondeve që do të dalin nga buxheti i shtetit, por ne kemi disa procese përnjëherë, si për shembull, misionin masiv të drejtësisë, që duan para, por të cilat janë të taksapaguesve, madje duket shpesh që vendi nuk do ta ketë bazën tek ekonomia dhe bujqësia, por te drejtësia; gjithashtu kemi Këshillin e Europës të fokusuar të reforma në drejtësi dhe përfarimi i legjislacionit; kemi procesin parapërgatitor që e kemi si pasojë e vendimmarrjes së Këshillit të BE-së në vitin 2018, me fokus të posaçëm kapitullin 23, që ju me të drejtë i referoheni. Pyetja që kam, përgjigjen e së cilës nuk e kam gjetur as te relacioni, as te prezantimi juaj është: cili është

plani juaj konkret i Ministrisë së Drejtësisë për të përfituar nga prania jonë në Agjenci? A kemi ne ndonjë avantazh krahasuar me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë? A kemi ndonjë specifikë ne apo jo?

Mimi Kodheli- Po, zoti Karamelo.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit!

Dëgjova parafolësit dhe u informova pak nga fjala e ish- ministrit. Unë dua të di nëse kjo Agjenci funksionon paralelisht me organet e tjera të BE-së? Nëse është e tillë, pse ne jemi kaq të vonuar në marrjen e këtij statusi, kur ne kemi marrë statusin e vendit kandidat shumë vite më parë? Është mungesë koordinimi, apo propozimi vjen nga kjo agjenci për t'u anëtarësuar?

Ka shumë anëtarësime të kësaj natyre që bën vendi ynë, shumë para të taksapaguesve shqiptarë shkojnë për të kontribuar, por efektiviteti i tyre shpeshherë mbetet i panjohur dhe ndodh që miratohen projektligje dhe marrëveshje, por nuk kërkohet llogari.

Unë mendoj se ka ardhur momenti, mbase ne si komision nuk na takon, por komisionet e tjera të Kuvendit duhet t'i kërkojnë llogari, sidomos Ministrisë së Drejtësisë për morinë e marrëveshjeve që janë bërë dhe që janë nënshkruar për reformën në drejtësi dhe efektiviteti i parave të shpenzuara në këtë drejtim. Mbase ky është një ogur i mirë, edhe fjala e zotit Bushati për efektivitetin.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zoti Beja fjala për ju.

Besmir Beja – Kapitulli 23 është një fushë e gjerë legjislacioni, bazuar në parimin e së drejtës dhe jo domosdoshmërisht mbi direktiva dhe për këtë shkak përafrimi i kësaj fushe të legjislacioni kërkon njohuri të veçanta, por edhe ekspertizë të posaçme. Vërtet Shqipëria në këtë fazë po përfiton ndihmë veçanërisht në kapitullin 23, por ne besojmë se pjesëmarrja në këtë agjenci është instrumenti më i mirë, sepse na jepet ndihmë e specializuar për çështje, të cilat agjencia është e specializuar. Këto çështje lidhen kryesisht me azilin, kufijtë, emigracionin, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e të dhënave dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Pra, në këto fusha, duke përdorur edhe të dhënat, veçanërisht modelet krahasimore, të cilat i përdor agjencia, vendet anëtare të Agjencisë do të mund të shohim dhe të matim ecurinë e reformave që ka ndërmarrë Shqipëria në këtë fushë, si edhe do të mund të ndjekim modelet e mira, të cilat mund të përthithen kollaj nëpërmjet instrumenteve që ofron Agjencia. Për këtë shkak pjesëmarrja në

Agjenci është themelore në përafrimin e legjislacionit, si edhe në matjen e efektivitetit të legjislacionit të përafruar.

Sa i përket pyetjes së dytë, kërkesa ka ardhur fillimisht nga zoti Bushati, kur ka qenë ministër i Jashtëm në vitin 2013. Kushti, siç u shpjegua, ishte që Shqipëria të kishte statusin kandidat për procesin e anëtarësimit në BE. Me marrjen e atij statusi kanë vijuar më pas procedurat e nevojshme për miratimin në parim të kësaj marrëveshjeje. Pra, është koha e nevojshme që parashtron legjislacioni në fuqi për miratimin e kësaj marrëveshjeje.

Mimi Kodheli- A do të ishte e nevojshme të kishim përfaqësues nga Ministria e Jashtme për diskutimin në parim?

Po, duhej të ishte e nevojshme.

Ralf Gjoni- Dëshiroj t'i bashkëngjitem shqetësimit të kolegut Bushati. Në fakt, më vjen keq që zëvendësministrja nuk është ende prezent.

Unë mendoj se duhet ta mbështesim si anëtarë të këtij komisioni anëtarësimin në këtë Agjenci, por unë nuk u informova siç duhet sa i përket planit të punës. Pra, çfarë masash konkrete do të merrni për të maksimizuar efikasitetin e pjesëmarrjes sonë në këtë Agjenci?

Mimi Kodheli- Zoti Beja, para se t'ju jap fjalën, nëse ju e keni një plan të tillë, jeni të lutur të na e lini një kopje pranë komisionit, që ne të ndjekim hap pas hapi zbatueshmërinë e këtij plani; nëse nuk e keni, ju lutem, na thoni kur mund ta keni gati.

Besmir Beja – Pjesëmarrja në instrumente të tilla ndërkombëtare jo domosdoshmërisht shoqërohet me një plan. Pra, qëllimi i Ministrisë së Drejtësisë është që nëpërmjet këtij instrumenti të përfitojmë nga asistenca dhe krahasimi i modeleve të ndryshme që ata mund të kryejnë. Me caktimin e përfaqësuesit të Shqipërisë me statusin e vëzhguesit në bordin e Agjencisë, do të bëjmë të mundur menjëherë të përfitojmë nga analizat studimore, si edhe asistenca e posaçme në fushat që agjencia ka, me qëllim që të përfitojmë sa më mirë eksperiencën e tyre.

Mimi Kodheli- Zoti Beja, statusi i vëzhguesit na jep të drejtën që ne të dimë ku duam të shkojmë. Pra, qëllimi ynë është ku duhet të shkojmë politikisht dhe teknikisht. Kështu që në gjykimin tim ne duhet ta kemi një plan të tillë, madje duhet të kemi të listuara një sërë ligjesh që mund dhe duhet të preken në respekt të statusit, por edhe të asaj ku duhet të shkojmë dhe që ka të bëjë me mënyrën si zbatohen të drejtat e njeriut në vende më të avancuara se ne.

Fjala për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ndjesë për vonesën për shkak të një angazhimi që kishim edhe me zëvendësministren e Drejtësisë.

Unë e vlerësoj nismën e kolegut Bushati, që në cilësinë e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme ka kërkuar që Shqipëria të jetë vëzhguese në një institucion shumë të rëndësishëm, siç është kjo Agjenci. Duke pasur parasysh fushat e veprimit të Agjencisë, që vepron në 10 fusha të rëndësishme, si: azili, të drejtat e fëmijëve, drejtësia, barazia gjinore e të tjera, unë do të vlerësoja ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, por do të thosha që më e rëndësishme është përzgjedhja, pra kush do të jetë përfaqësuesi, pasi, nëse ne i referohemi rregullores me të cilën vepron kjo Agjenci, pikërisht nenit 12 të saj, ku thuhet që në bordin drejtues përfshihen persona me përvojë të përshtatshme në menaxhimin e publikut dhe në organizatat në sektorin publik dhe privat, personalitete në fushën e të drejtave të njeriut, personi që do të vendoset duhet të ketë njohuri nga të gjitha këto fusha.

Nga ana tjetër, ky person që do të zgjidhet duhet të jetë i pavarur, pavarësisht se mund të propozohet nga qeveria, por mund ta propozonte parlamenti. Kjo është një pyetje për shembull që do ta bëja, pse duhet të përzgjidhet nga ministria e Drejtësisë dhe jo nga dikush tjetër?

Pra, ky person duhet të jetë një zë i fuqishëm . Unë pajtohem me sugjerimin që bëri kryetarja e komisionit kur tha se Agjencia ka një rol shumë të rëndësishëm. Ajo krijon kulturën e mbrojtjes së të drejtave themelore në të gjithë BE-në. Kjo do të thotë se kjo agjenci harton opinione dhe jep mendime nëse legjislacioni është në përputhje me standardet. Unë mendoj se është shumë e rëndësishme, meqë jemi një vend kandidat dhe presim të hapim negociatat dhe që me të drejtë kryetarja e komisionit tha që kemi shumë nevojë për të përafruar pjesë të legjislacionit shqiptar në të 10 fushat ku vepron agjencia me direktivat e BE-së. Mendoj se kjo detyrë duhet të jetë shumë e rëndësishme për atë person që nominohet, por mbi të gjitha kjo ka edhe një faturë financiare. Do të vlerësoja shumë që kontributi që do të japim nga pikëpamja financiare nga buxheti i shtetit të justifikojë edhe rolin që do të ketë vëzhguesi ose zëvendësvëzhguesi në këtë proces.

Pyetja ime është kjo: pse pikërisht i është lënë Ministrisë së Drejtësisë të bëjë propozimin e përfaqësuesit? Nga jeni nisur, sepse rregullorja e kësaj Agjencie nuk ka përcaktuar ndonjë rregull se kush duhet ta propozojë.

Unë besoj se brenda 4 muajve duhet të fillohet të operohet, a keni planifikuar se cili do të jetë kontributi i këtij personi në këtë agjenci?

Mimi Kodheli - Zonja zëvendësministre, fjala për ju.

Fjoralba Caka- Faleminderit!

Ndjesë për vonesën.

Mimi Kodheli - Jeni e justifikuar, kështu që kaloni te përgjigjet.

Fjoralba Caka- Lidhur me pyetjen e parë të zonjës Hysi, në ratifikimin e marrëveshjes neni 2 parashikon që përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë në bordin drejtues të Agjencisë Europiane për të Drejtat Themelore emërohet nga ministri i Drejtësisë, sipas parashikimit të rregullores nr.168/2007.

Sa i përket faktit pse është Ministria e Drejtësisë ose pse potencialisht do të jetë ky subjekt që do të mbajë marrëdhëniet me FRAB-in, ne kemi bërë një studim paraprak si Ministri e Drejtësisë për të parë përfaqësimin në nivel bordi nga vendet e tjera, qofshin këto anëtare, por edhe vende që kanë statusin e vëzhguesit. Nga vërtetimi paraprak që ne kemi bërë rezulton që ka vende ku përfaqësuesi është nga Ministria e Drejtësisë, ka vende ku është nga Avokati i Popullit , si edhe ka vende ku përfaqësuesi është nga shoqatat e shoqërisë civile. Patjetër që pas miratimit të këtij këtij projektligji Ministria e Drejtësisë do të ketë një konsultim publik ku ne do të dëgjojmë opinione të shoqërisë civile ose edhe të institucioneve të tjera se cili mund të jetë institucioni përfaqësues. Duke pasur në konsideratë edhe faturën financiare, qëpaguhet nga Ministria e Drejtësisë, edhe faktin që Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për kapitullin 23, ku pjesë e këtij kapitulli është mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, ne jemi në pozicionit e koordinuesit dhe jemi të përshtatshëm për të përfaqësuar shtetin në këtë bord.

Në kuadër të procesit të anëtarësimit në kapitullin 23, krahas reformës në drejtësi dhe korrupsionit, Ministria e Drejtësisë po luan një rol shumë të rëndësishëm koordinues me 17 institucione të tjera për të parë nivelin e respektimit të të drejtave themelore të tyre, legjislacionin, si është përafruar dhe masat që janë marrë. Nisur pikërisht nga ky pozicion kyç që ka Ministria e Drejtësisë në koordinimIN dhe mbledhjen e informacionit, ne çmujmë që Ministria e Drejtësisë është një aktor i përshtatshëm për përfaqësim. Gjithsesi, nuk shmangim edhe mundësinë e konsultimit.

Ditmir Bushati – E di që Evisi do të më kritikojë që unë e mora fjalën prapë, por unë insistoj në një pikë, që për mua është themelore. Kur flas për nevojën për të pasur një plan ose

strategji se si ne i qasemi këtij procesi, nuk e kam fjalën për aspektet formale që nuk janë në dorën tonë, e kam fjalën te qasja përfituese dhe kontribuuese që ne mund të kemi në këtë proces. Unë nuk e shoh në asnjë resht të arsytimit që ka sjellë Ministria e Drejtësisë specifikën që ka BE-ja dhe arsyen përse ne e kemi nisur këtë proces. BE-ja ka një katalog të të drejtave të njeriut. Edhe zonja Hysi e tha që vendet anëtare dhe më pas vetë BE-ja, teksa përgatit legjislacionin, mund të mbështeten tek ekspertiza e agjencisë për të pasur një opinion më të specializuar në raport me këtë kartë të të drejtave të njeriut që në arkitekturën ose në hierarkinë e vlerave ligjore brenda BE-së ka një vlerë specifike, nuk janë pjesë të traktateve. Prandaj mua ma vret veshin kur këtu thuhet përafrimi legjislacionit, sepse nuk dua ta kthej në debat teknik, por pastaj për çfarë do t'i drejtoheni ju TAEKS-it, EURALIUS-it, ose konsulencave të ndryshme apo aktit që do të miratojmë pak më vonë me ndihmën gjermane për fushat e sundimit të së drejtës në ekonomi, që ka vite e vite që GIZ-i merret me këtë punë.

Shqetësimi që ngriti zonja Hysi i shtohet shqetësimit që parashtrova. Pra, këtu kemi dy elemente: e para, nevojën për të pasur një qasje më strategjike në raport me këtë proces. Deri sa na ka shkuar 4-5 vjet për të mbyllur procedurën për shkak të burokracisë që kërkon ajo, tashmë duhet të kemi një gjë të qartë, mua nuk më shqetësojnë 160 mijë eurot e buxhetit të shtetit në këtë pikë, se sa më shqetëson fakti që le t'i kemi edhe 160 mijë të tjera, vetëm të kemi një konsulent që Ministria e Drejtësisë dhe ne këtu që ngremë dorën, ta kemi të qartë se cila është harta e rrugës dhe se si do ta përfitojmë atë. Kjo është çështja, sepse ju dëgjova që thonin jo 17 institucione me kapitull 23 e të tjera dhe çfarë do t'ju bëjë juve që këtë ta konsideroni si një vlerë të shtuar në raport me të gjitha proceset e tjera që bëhen. Kjo për mua është gjëja e parë themelore.

Së dyti, është shqetësimi që ngriti me të drejtë zonja Hysi, së cilës i bashkëngjitem, pse e kanë krijuar vendet anëtare këtë gjë, nevojën për të pasur një vetëdijesim më të madh për sa i përket lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut. Edhe politikisht po ta doni, koncepti me të cilin përballët BE-ja sot për çështjet e migracionit dhe dallimet e mëdha që ekzistojnë mes Veriut, Jugut, Lindjes dhe Perëndimit të Europës edhe për shkak të barrës dhe kontributit në këtë proces, nuk mund të na bëjnë ta shohim edhe këtë me shumë qetësi dhe të themi se një nga fushat është edhe migracioni apo azilkërkimi, sepse nevoja që ka Bashkimi European është e ndryshme fiziologjikisht nga nevoja që kemi ne si vend kandidat apo si vend që mund të jemi pjesë e të

gjithë rrugës, që jam i bindur se edhe zonja Gjebrea duhet ta ketë eksploruar kur ka përgatitur relacionin për këtë çështje.

Pra, këto janë shqetësimet që duam të dimë, pastaj me ato idetë që pas dy apo tre javësh do të na vijë një plan veprimi, mua si deputet më duhet një qasje që ta di ku jemi me këtë gjë.

Mimi Kodheli – Zëvendësministre, fjala për ju.

Belinda Ikonimi – Faleminderit, zoti Bushati!

Lidhur me vërejtjet dhe komentet tuaja për sa i përket anëtarësimit tonë pranë kësaj agjencie, më lejon të sqaroj diçka për kartën, që patjetër bashkërisht për shkak se jemi studiues të Bashkimit European, jemi në thellësi të faktit se si funksionon karta, por më duhet ta sqaroj këtë, duke qenë se kemi edhe kamerat të pranishme për publikun që na dëgjon.

Karta e Bashkimit European për të drejtat themelore të njerit është detyruese vetëm për institucionet e Bashkimit European dhe për shtetet anëtare të BE-së, vetëm kur këto shtete anëtare zbatojnë legjislacionin european. E thënë kjo, karta për Shqipërinë nuk ka asnjë efekt juridik. Pra, ne po anëtarësohemi jo për shkak të kartës, arsyeja pse po anëtarësohet Shqipëria sikundër edhe vende të tjera me statusin e vëzhguesit, Maqedonia apo vetë Serbia, ka të bëjë me aplikimin aktualisht të standardeve të të drejtave themelore të njeriut në BE.

Ne e dimë shumë mirë që përveç kartës në BE ekzistojnë jo vetëm mbrojtja pranë KEDNJ-së, por edhe mbrojtja në nivel kushtetues dhe ajo që po përjeton si Gjykata Europiane e Strasburgut, e Luksemburgut, po ashtu, janë dy jurisprudenca ku për të njëjtën të drejtë themelore të njeriut kemi praktika të ndryshme. Rasti DEB dhe raste të tjera pranë gjykatës tregojnë se edhe për nenin 6, që është proces i rregullt ligjor, me të cilin Shqipëria ka një sërë problemesh, standardet e mbrojtjes po livrohen nga dy gjykata në mënyra të ndryshme. Agjencia u shërben si një forum, jo vetëm shteteve anëtare, por edhe organizatave të shoqërisë civile, ku janë anëtarësuar rreth 400, po kështu edhe vendet që do të anëtarësohen, për të diskutuar pikërisht për standardet e të drejtave themelore në BE, pasi ky është një debat, i cili ka gjeneruar që pas traktatit të Lisbonës, që në momentin që karta ka fituar fuqi juridike njësoj si traktatet. Arsyeja pse ne futemi në këtë forum është pikërisht për të marrë praktikat më të mira, për të parë tendencat e zhvillimit të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut dhe për të garantuar mbrojtjen e standardeve europiane, sikundër e kërkon BE-ja. Kjo është e lidhur me procesin e anëtarësimit, ndaj edhe unë përmenda kapitullin 23, sepse kriteri politik dhe monitorimi i të

drejtave themelore të njeriut, sipas standardeve europiane, kërkon që edhe niveli i mbrojtjes të jetë rigoroz dhe përkatës me këtë standard.

Jo thjesht për të imituar vendet e rajonit, por duke parë agjencinë, duke parë tendencën dhe dëshirën tonë për të mbrojtur siç duhet të drejtat themelore të njeriut, ne propozojmë këtë iniciativë.

Patjetër që elementet teknike si përfaqësimi i Ministrisë së Drejtësisë apo dikush nga shoqëria civile, është një debat që unë jam e sigurt që me Drejtorinë e Kodifikimit do ta rihapim, por Ministria e Drejtësisë e konsideron me vlerë një anëtarësim të tillë, por kjo mbetet në vlerësimin tuaj, të nderuar deputetë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti ish-ministër, fjala për ju.

Ditmir Bushati – Më falni, se ju ishit në aktivitet tjetër dhe nuk u kuptuam, për nevojën për t'u përfshirë Shqipëria në këtë agjenci, siç e keni shkruar në relacion. Ky proces ka filluar që në vitin 2013 dhe u tha edhe këtu, po e përsëris edhe unë, që një nga ata personat, për shkak të funksionit, kam qenë edhe unë. Vendimi është marrë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit që bashkëdrejtohej nga unë. Pra, ne këtë gjë e ezauroam. Neve nga ky moment e tutje na intereson vlera jonë e shtuar. Unë u përpoqa për ta shpjeguar, e vlerësoj shumë edhe shpjegimin tuaj për gjykatat, për sfidat e të tjera pikërisht sepse jemi në këtë pozitë të vendit kandidat dhe duam të përgatitemi dhe kemi kohë për ta bërë këtë iks vite sa të shkojë procesi. Pyetja që ngrita unë, por besoj e kishin edhe kolegë të tjerë, ka lidhje me strategjinë tonë përfituese në këtë proces, duke pasur parasysh specifikat e agjencisë dhe jo nevojën që është shprehur nga shteti shqiptar që në dhjetor të vitit 2013 për të qenë pjesë e këtij organizmi.

Mimi Kodheli – Besoj se komentet ishin shteruese nga të gjitha palët dhe ky komision është për dhënie mendimi. Gjithçka që ne kemi kërkuar dhe pretenduar nga institucioni që ju përfaqësoni do të jetë e shkruar në procesverbal dhe do t'i transmetohet edhe komisionit përgjegjës për projektligjin. Besoj se atë çka do t'i transmetojmë komisionit përgjegjës lidhur me çka folëm, mund të ishte edhe një reflektim i komisionit përgjegjës për kërkesat tona për një hapje të një debati që ka lidhje me *road map*-in, me strategjinë në zbatim dhe atë çka ne sjellim dhe i shtojmë këtij statusi, që shpresoj se me këtë projektligj do ta marrim, ndaj thjesht më mbetet ta hedh në votim në parim për miratim dhe më pas nuk na pengon miratimi i projektligjit,

le të themi pasurimin e punës sonë të përbashkët me atë çka kemi pretenduar dhe kërkuar nga Ministria e Drejtësisë në këtë rast.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Edhe një herë, për procedurë e hedhim në votim në tërësi projektligjin, se më pas zyshë Lika na tërheq vërejtjen. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju falënderoj për prezencën, zëvendësministre!



KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.09.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Ralf Gjoni, Evis Kushi, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Reme Lala, Alket Hyseni

Mungojnë:

Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Rudina Hajdari, Taulant Balla

Të ftuar:

Erjon Luci - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Anuela Ristani - Nënkryetare e Bashkisë Tiranë

Ilda Qazimllari - Përgjegjëse e Sektorit të Zbatimit dhe Marrëdhënieve Ligjore e Financiare, në Drejtorinë e Implementimit të Investimeve të Huaja, në Bashkinë e Tiranës

Tedi Bushaj – Përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Mimi Kodheli – Pika tjetër e rendit të ditës është diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”. Relatore e këtij projektligji është kolegja Kushi.

Të ftuar kemi zonjën Belinda Ikonimi, zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zonjën Ristani, nënkryetare e Bashkisë së Tiranës, zonjën Qazimllari, përgjegjëse sektori dhe zotin Tedi Bushaj, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pa humbur kohë, zonja Ikonimi, fjala për ju.

Belinda Ikonimi – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Këshilli i Ministrave ka depozituar në Kuvend për ratifikim kredinë që qeveria shqiptare ka marrë nga Banka Europiane e Investimeve për rehabilitimin e lumit Lana në Tiranë. Marrëveshja parashikon një kredi prej 8 milionë eurosh, me një grant prej 2,4 milionë eurosh. Në fakt, është edhe materiali tjetër, që është depozituar gjithashtu pranë Kuvendit. Nëpërmjet këtij financimi synohet të realizohet zgjatimi i bulevardit nga ura teknologjike deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të Lumit të Tiranës, po në këtë segment.

Pa dyshim, ky është një projekt i rëndësishëm që besohet se do të ketë një impakt pozitiv për të gjithë zonën dhe pritet të zbatohet nga Bashkia e Tiranës deri në muajin shkurt të vitit 2022.

Gjithashtu, parashikohet që gjatë projektit të kemi zgjatim të bulevardeve me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, sinjalistikën, disiplinimin e ujërave të bardha e të ndotura duke zgjidhur gjithashtu problematikën që kanë qenë në atë zonë lidhur me përmytjet.

Për më tepër detaje teknike të projektit dhe për rëndësinë që ka ky projekt për zhvillimin e qytetit të Tiranës, këtu kemi edhe përfaqësuesin e Bashkisë së Tiranës.

Ju faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, zëvendësministre!

Kolegja Kushi, fjala për ju.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetare!

Mendoj se do të jetë lajm i mirë miratimi i këtyre projektligjeve, një marrëveshje financiare prej 8 milionë eurosh dhe një marrëveshje granti prej 2,4 milionë eurosh, të dyja të

lidhura midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për të financuar projektin e zhvillimit urban të shtratit të lumit të Lanës.

Nuk dua të ndalem gjatë në detajet teknike të këtyre dy marrëveshjeve, sepse mendoj se në Komisionin e Ekonomisë, i cili është edhe komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve, mund të trajtohen këto çështje, por shumë shkurt dua të theksoj rëndësinë e këtij projekti.

Bëhet fjalë, siç e tha edhe zëvendësministrija, për zgjatimin e dy bulevardeve, konkretisht: bulevardet “Bajram Curi” dhe “Gjergj Fishta”, si dhe rehabilitimin e shtratit të lumit të Lanës në këtë segment.

Gjithashtu, dua të specifikoj që standardi i punimeve që është parashikuar në projekt nënkupton regjimin hidraulik eficient, që do të thotë se i jep zgjidhje problematikës së hershme të përmbytjeve në këtë zonë.

Në mënyrë të përmbledhur kemi të bëjmë me përmirësimin e infrastrukturës tejet të amortizuar në këtë zonë, kemi të bëjmë me një infrastrukturë të re të qëndrueshme, dhe, së treti, me zhvillimin urban të zonës që prek ky projekt.

E them këtë pasi është e qartë që kudo ku ka punë infrastrukturore, natyrisht që këto shoqërohen me zhvillim ekonomik dhe social të këtyre zonave.

Nga aspekti ligjor këto dy projektligje vijnë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërkohë që nga aspekti procedural, të dyja projektligjet vijnë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Për të gjitha këto përfitime dhe për efektin e rëndësishëm që do të japë, ju sugjeroj, kolegë, t’i miratojmë të dyja këto projektligje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Kushi!

Në fakt, ju cekët të dy projektligjet që kanë lidhje me njëri-tjetrin, gjithsesi do t’i miratojmë të veçuar.

Keni pyetje kolegë? Fjala për zotin Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Kisha një pyetje të kësaj natyre, që është më shumë për bashkinë: gjatë realizimit të projektit, a do të nevojiten shpronësime? Në qoftë se po, a janë parashikuar fonde për të realizuar këto shpronësime, se shpesh ka pasur probleme lidhur me to?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën jua jap unë, zonjë! Ka pyetje të tjera, kolegë?

Fjala për zonjën Ristani.

Anuela Ristani – Faleminderit!

Në vlerën totale të projektit janë bërë parashikime për shpenzime të mundshme. Shpronësime specifike në zonën ku do të kalojë projekti do të vërehen nga pjesa e dokumentacionit të zonave dhe pronave që janë aktualisht aty.

Doja të theksoja që përveç shpronësimeve, që janë pjesë e faturës financiare për projektin e plotë, ne kemi marrë parasysh që ka edhe raste të trajtimit të veçantë, pra banesa ose banorë që nuk kanë dokumente për pronat e tyre, që do të trajtohen me programet tona sociale. Fatura totale e projektit përfshin edhe shpenzimet e mundshme që do të jenë.

Mimi Kodheli – Nëse nuk ka pyetje të tjera, unë kam një pyetje për zonjën zëvendësministre: në relacion thoni: “Kredia që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate ka shumën 8 milionë euro, maturimi 20 vjet me interes të përcaktueshëm në bazën e tregut në momentin e disbursimit”. Kështu është edhe kontrata, ku interesi mund të jetë i lartë, për shembull? Domethënë, kontratë me interes të përcaktuar mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit, rrallë kam parë.

Bellinda Ikonimi – Zonja kryetare, në fakt për këtë material duhet të ishte pjesëmarrës zëvendësministri tjetër, zoti Luçi. Ju kërkoj ndjesë që nuk mund t’i përgjigjem kësaj pyetjeje teknike, pasi është jashtë fushës që mbuloj.

Do t’ju lutesha që kthimin e kësaj përgjigjeje ta bëjmë në një moment të dytë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Patjetër! Ju falënderoj, zonja Ikonimi!

Gjëja tjetër që do të doja t’ju pyesja ka të bëjë me garancitë që duhet të ketë kontrata. Me sa di unë, qeveria merr kredi dhe Bashkia e Tiranës është përfituesja. Cila është garancia sot (po e them me humor këtë!)?

Anuela Ristani – Financimi i projektit nga granti dhe nga kredia janë më pak se 50 % e shumës së projekteve në total, në qoftë se shikojmë relacionin. Bashkia e përfiton shumën nga marrëveshja e qeverisë. Garancia jonë është pjesa që ne do të investojmë te projekti, qofshin këto shpronësime, apo pjesa tjetër e projektit, e cila mbetet pa financim.

Do të doja të shtoja që projekti është gjithëpërfshirës, pjesa e supervizimit dhe konsulencat që nënkontraktohen, jo vetëm thjesht implementi apo infrastruktura, kështu që nuk do të ketë kosto ekstra të përfshira këtu.

Garancia e Bashkisë së Tiranës është implementimi i projektit dhe pastaj kontributi i buxhetit të bashkisë për pjesën tjetër të mbetur.

Nga ana kontraktuale, nuk di t'ju përgjigjem, sepse është thjesht marrëveshje midis...

Mimi Kodheli – Pra, në qoftë se ju kam kuptuar drejt, ju do të mbuloni kryesisht shpronësimet. Jam e saktë?

Anuela Ristani – Projekti i detajuar përfshin të gjitha elementet, që nga puna infrastrukturore, nga rrjeti i shtruar nga fillimi, nuk bëhet fjalë për rehabilitim, por për punime të reja joekzistuese, gjithë pjesa e mbikëqyrjes dhe të supervizimit të punimeve, gjitha pjesa e fizibilitetit dhe të impaktit në mjedis dhe popullatë, dhe pastaj, të gjitha shpronësimet apo rialokimet e banorëve të zonës, në qoftë se do të duhet.

Mimi Kodheli – Kam edhe një pyetje dhe e mbyll. Pastaj do t'ia jap fjalën zotit Gjoni.

Sa për qind të buxhetit vjetor të bashkisë përfaqëson investimi që keni ju, si bashki, jo pjesa e qeverisë?

Anuela Ristani – Investimi do të ndahet në vite, 20 vjet. Përgjithësisht, nga ana e pjesës së investimeve të buxhetit që ne alokojmë për investime në vijimësi historikisht në këta vjet, bëhet fjalë për 20-30 milionë investime në vit. Në rastin e shumës që do të përcaktojmë, e ndarë kjo në vite sipas nevojës, sepse ky është vlerësim maksimal, vlerësimi për shpronësimet nuk është bërë ende, duhet të jetë një përqindje e këtij investimi, pra bëhet fjalë për 20-25% në vit për këtë projekt.

Mimi Kodheli – Pra, në qoftë se nuk e kam kuptuar gabim, ne do të fillojmë me shpronësimet, pastaj do të fillojë implementimi i projektit, apo jo?

Anuela Ristani – Patjetër, por vlerësimi teknik i shpronësimeve për këtë projekt nuk është bërë ende në terren.

Mimi Kodheli – Pra, ju nuk keni një shumë të mirëpërcaktuar se si do të jetë vlera e shpronësimeve në terren?

Anuela Ristani – Ne kemi bërë vlerësimin e shumës maksimale që do të na duhet në qoftë se të gjitha banesat në gjurmën e projektit do të rezultonin me dokumentacion.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Fjala për zotin Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Si çdo projekt ku bëhet fjalë për miliona euro dhe për projekte transporti apo ndërtimi, ku përfshihen edhe shpronësime, ka një dhënës, ka një marrës, ka edhe një zbatues. Dhënësin e dimë, marrësi është Bashkia e Tiranës, zbatuesi do të jetë një palë e tretë.

Sipas kontratës së lidhur, te pika 6 flitet për angazhime të tjera, pra, për një mekanizëm efektiv të korrigjimit që siguron procedurat e shqyrtimit të pranueshme për bankën.

A ka një plan fizibiliteti të qartë nga ana juaj për sa i përket zbatueshmërisë së këtij projekti? Çfarë mekanizmi efektiv parashikoni për të shqyrtuar të gjitha ankimimet apo ankesat që mund të dalin gjatë rrugës së prokurimit, bëhet fjalë për një seri tenderash që do të merren nga zbatues subjektsh private të treta dhe çfarë masash parashikoni ju të merrni për të lejuar që çdo person i tretë, çdo zbatues i mundshëm, i cili ka ankesa për procedurat e prokurimit, sipas ligjeve në fuqi, kuptohet, të trajtohet me transparencë të plotë, ashtu siç e kërkon edhe Banka Europiane për Investim?

Anuela Ristani – Kontrata pak a shumë krijon kornizën në të cilën do të punohet. Për rastin e këtij financimi dhe për raste të tjera kur ne bashkëpunojmë me banka investimesh apo me institucione ndërkombëtare financiare, të gjitha rregullat e prokurimit dakordësohen në bazë të marrëveshjes që ka bërë shteti shqiptar me subjektin në fjalë. Edhe në këtë rast ne jemi subjekt i këtyre rregullave dhe i kësaj procedure. Procedurat pastaj detajohen bashkë me stafin tonë të prokurimeve që të jenë në përputhje me legjislacionin.

Masat që ne marrim nuk më duket sikur janë parandaluese, por janë të njëjtat në mënyrë institucionale që do të ndiqen dhe siç janë ndjekur në çdo lloj marrëveshjeje tjetër që kemi pasur.

Kjo marrëveshje nuk është e para që bëhet nga Bashkia e Tiranës me financim ndërkombëtar, kështu që edhe në rastet e tjera është ndjekur po e njëjta procedurë dhe të gjithë janë palë e përzgjedhjes, e procesit, në qoftë se e kam kuptuar drejt pyetjen.

Ralf Gjoni – Në fakt, unë e kisha për sa i përket infrastrukturës dhe mekanizmit në terren nga ana e bashkisë për zbatueshmërinë e këtij projekti. Si parashikoni të ndaloni që zbatuesi, një palë e tretë që fiton një tender, nuk e delegon te një palë tjetër dytësore punën që është fituar nga ai në kuadër të tenderimit. Pra, nuk po flasim vetëm për infrastrukturën juridike dhe ligjet në fuqi. Pra, çfarë plani pune konkret dhe mekanizmi efikas keni ju në bashki për të garantuar që të ndodhë një praktikë jo e ligjshme gjatë rrugës së zbatueshmërisë së këtij projekti?

Faleminderit!

Anuela Ristani – Në qoftë se mund t’ju kërkoj leje, kryetare, kolegia ime, Ilda Qazimllari, e cila merret me zbatueshmërinë e projektit, mund t’ju japë një përgjigje më të saktë.

Ilda Qazimllari – Faleminderit për fjalën!

Donim të sqaronim diçka: Banka Europiane e Investimeve mund të themi se është ndër bankat unike në procedurat e saj në momentin që jep kredi apo grante. Si e tillë, një ndër pikat kryesore që banka ka dhënë që në krye të dakordësimit dhe të negocimit me Bashkinë e Tiranës, por edhe me Ministrinë e Financave, kanë qenë komitetet për sa u takonin ankimimeve, të cilat fillonin që nga procesi i prokurimit deri në ankimimet që do të ndiqeshin në forma qoftë telefonike, qoftë anonime gjatë zbatimit të projektit. Të gjitha këto përmes një *Resettlement Action Plan*, që, në fakt, në përmbajtje nuk ka vetëm sistemimin e personave që do të hiqen nga godinat, por ka në thelb edhe trajtimin e të gjitha ankimimeve që vijnë që nga prokurimi deri në momentin final, që është zbatimi, qoftë edhe efektet që vijnë nga ndotja akustike, apo efekte të tjera në dukje anësore. Të gjitha janë të trajtuara në dy prej dokumenteve, të cilat do të duhet t’i miratojmë deri në fund të vitit dhe t’i drejtohem i që është: *Resettlement Action Plan* dhe *Stakeholder Engagement Plan* ku përcakton secili çfarë bën. Nga ana e Bashkisë së Tiranës është ngritur njësi e menaxhimit të projektit, e cila do të bëjë koordinimin e së gjithës si proces.

Alket Hyseni - Faleminderit, zonja kryetare!

E kuptoj edhe kuriozitetin e shumë kolegëve për të bërë pyetje që kanë lidhje me zbatueshmërinë e projektit, por më lejoni t’ju kujtoj që ne jemi Komisioni i Jashtëm.

Arsyeja që është kaluar për dhënie mendime kjo marrëveshje, ka të bëjë me faktin nëse kjo marrëveshje sjell komplikacione lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me shtetin që e financon, apo jep grantin?

A ka ndonjë problematikë me strategjitë tona të integritetit apo të marrëdhënieve me të tretët? Përtej kureshtjes së kolegëve, do të sugjeroja që kushdo që ka interes të drejtpërdrejtë, të marrë pjesë te komisioni përgjegjës ku diskutohen. Të mos ngatërrojmë rolin tonë këtu.

Do të mirëkuptoja ndonjë deputet të Tiranës se mund të ketë shqetësime, por edhe atë deputet do ta ftojta të marrë pjesë te komisioni përgjegjës. Këtu diskutohet në Komisionin e Jashtëm dhe tërheq vëmendjen nga pikëpamja procedurale të mos ngatërrojmë rolin që kemi si Komisioni i Jashtëm.

Nga ana tjetër, meqë mora fjalën, e mbështes marrëveshjen pa ekuivok dhe ftoj kolegët ta votojmë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ne do t'i votojmë më vete, pavarësisht se po i diskutojmë të dyja projektligjet.

Unë e falënderoj kolegun Hyseni për komentet, është e drejtë ajo që tha, por kjo nuk na e heq të drejtën të pyesim edhe për çështjet teknike, sepse, në fund të ditës, para se të jemi anëtarë të një komisioni, jemi deputetë, kështu që na ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ekonomist, thotë...

Për faktin se nuk bëj dot anëtarin e komisionit diku tjetër apo për shkak të detyrës që kam, nuk mund të më heqësh të drejtën të pyes për interesat, sepse kam qenë shumë vjet financiere, Alket, dhe është më e fortë ajo ndjesi sesa kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë e kam ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket, unë kam djersitur më shumë në profesionin e financierit, sesa në këtë të politikanit.

(Diskutime pa mikrofon)

Për procedurë, dy minuta, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Zonja kryetare,

Të nderuar kolegë,

Ne jemi deputetë. Unë jam deputet i qarkut të Tiranës. Jam në të drejtën legjitime të bëj çfarëdolloj pyetjeje që më vjen në mendje në këtë komision, por, në fakt, interesimi im buronte nga marrëdhënia kontraktuale midis Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Bankës Europiane të Investimeve. Pyetja ime ishte në kuadër të kësaj marrëdhënieje kontraktuale për zbatueshmërinë e procedurave të trajtimit të ankimimeve nga ana e bashkisë. Nuk mendoj se ka ndonjë problem dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mbaroj!

Nuk besoj se kolegët tanë të bashkisë apo të ministrisë e kanë problem. Unë mendoj se ata e morën me shumë konstruktivitet pyetjen dhe interesimin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zoti Hyseni, jam dakord me zonjën kryetare dhe mendoj se është në dinjitetin e këtij komisioni që ne si deputetë të ngremë çdo shqetësim të mundshëm legjitim dhe t'i kërkojmë ...

Ne nuk duhet të jemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

E përsëris, ne duhet të rrisim kërkesën e llogarisë ndaj çdo institucioni të ekzekutivit qendror apo vendor. Mendoj se është më transparente të dëgjojmë edhe mënyrën se si e ka parashikuar bashkia.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Gjoni!

Meqë jemi më transparentë dhe më bashkëpunues, unë ju ftoj të miratojmë, së pari, projektligjin për ratifikimin e kontratës dhe më pas ratifikimin e marrëveshjes së grantit. Jemi te pika e parë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ju ftoj të votojmë për ratifikimin e marrëveshjes së grantit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Investime në projektin “Shtrati i lumit “Lana” në zhvillimin urban”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ministri Bushati, ju lutem, dorën!

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Miratohet në tërësi.

Falënderoj kolegët për prezencën!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Procesverbal

Tiranë, më 30.09.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik të vitit 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Rudina Hajdari

Mungojnë:

Elona Hoxha, Evis Kushi.

Të ftuar:

Belinda Ikonimi - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi – Përfaqësuese nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji i fundit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”. Relator do të jetë kolegu Shameti. Ndërkohë, vazhdojmë të kemi nderin të kemi prezente zëvendësministren Ikonomi dhe zonjën Hafizi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Mirë se vjen, kolege e vjetër, Hafizi!

Zonja zëvendësministre, fjala për ju për projektligjin e fundit që po diskutojmë.

Faleminderit!

Belinda Ikonomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Sot kemi një projektligj për mbështetjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik. Procesi i integritetit është pa dyshim një nga prioritetet kyçe dhe procesi i negociatave të anëtarësimit është një proces sa politik, aq edhe teknik. Pa dyshim, suksesi vjen nga niveli i përgatitjes së administratës shqiptare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka peshën më të madhe si lider i 13 kapitujve, prandaj është gjykuar se ne kemi nevojë për mbështetje në këtë proces, në kapituj të caktuar, që janë me interes për Komisionin Europian. Për këtë arsye, në bazë të protokolleve dhe takimeve, qeveria gjermane është angazhuar të sigurojë financimin e projektit me një shumë prej 2 milionë eurosh, me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, i cili do të implementohet nga GIZ-i. Ky është një projekt në vijim, pasi projekti fillestar ka qenë për vitet 2015-2018, ku angazhimi dhe ndihma ka qenë në përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, por tashmë kjo mbështetje do të jepet më tepër në zhvillimin e kapaciteteve dhe metodologjisë. Pra, në këtë fushë pritet t’i jepet prioritet pajisjes së anëtarëve të grupeve ndërinstitucionale për kapituj me instrumente pune, me njohuri dhe aftësi të nevojshme për zhvillimin e negociatave.

Një element tjetër i rëndësishëm është parapërgatitja për të adresuar kushte potenciale për hapjen dhe mbylljen e negociatave në kapituj të caktuar. Gjithashtu, kërkohet mbështetje për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe e planeve të veprimit, shoqëruar edhe me masa për zhvillimin e kapaciteteve personale në hartimin e tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm është edhe përfshirja e shoqërisë civile. Pikërisht në këtë fushë pritet mbështetje për identifikimin e aktorëve të rëndësishëm dhe për përfshirjen e shoqërisë civile, sipas fushës së caktuar, në procesin e bisedimeve të anëtarësimit.

Shpresojmë që ky material të miratohet, sepse është një mbështetje shumë e madhe për strukturën e Ministrisë së Financave. Sikurse e thashë, ka edhe peshën më të madhe në kapituj dhe, pa dyshim, ka një punë kolosale përpara.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

Kolegu Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Sikurse edhe zëvendësministrja e linjës e parashtrori para komisionit, projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Kjo marrëveshje është propozuar nga Republika Federale e Gjermanisë nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar marrëdhëniet midis dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit teknik dhe qëllimit për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë në protokollin e bisedimeve të vitit 2018.

Objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti është forcimi i kompetencave për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, me fokus në disa kapituj të caktuar të legjislacionit të BE-së, që i përkasin kryesisht sektorit ekonomik. Mbështetja dhe zbatimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për anëtarësim.

Zëvendësministrja referoi detajet teknike. Në mbyllje të fjalës sime dua të them se, duke qenë se në aspektin ligjor projekti i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe ftoj kolegët e komisionit ta miratojmë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shameti!

Jeni shterues dhe bindës në të njëjtën kohë.

Ministri Bushati, a keni pyetje?

Ditmir Bushati – Nuk kam pyetje.

Jam i qartë për këtë procedurë.

Për efekt të procesverbalit doja të nënvizoja se në rast se ka një shtet dhe një grup ekspertize që realisht “martohen”, paraja që shpenzohet me ekspertizën që ofrohet, është shteti gjerman. Doja ta mbështesja këtë proces dhe të nënvizoja edhe një herë tjetër atë që tha zëvendësministri, që Ministria e Ekonomisë dhe Financave, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë apo sundimin e së drejtës në ekonomi, ka peshën kryesore, ndaj besoj se kjo do të jetë një ndihmë shumë e çmuar. Si gjithmonë, kjo ndihmë nuk shkon vetëm për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, por edhe për fuqizimin e kapaciteteve, qofshin brenda administratës apo jashtë saj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Unë i bashkohem me ministrin Bushati dhe e mbështes në atë çfarë tha.

Një falënderim i veçantë dhe shumë i ndier është për Republikën Federale të Gjermanisë për ndihmën shumë të vyer, sidomos në rritjen e kapaciteteve dhe asistencës së tyre për gjithçka na pret në rrugën e vështirë të përafrimit të legjislacionit dhe të të gjitha punëve të përbashkëta që kemi në rrugën e integritit.

Ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj, duke shpresuar dhe besuar fort që jemi në rrugën e duhur dhe duke bërë gjënë e duhur.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1 i projektligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 i projektligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Zoti Karamelo, ngrini dorën, sepse aty ka vëzhgues, të cilët vëzhgojnë kur unë them: “Kundër? Abstenim? Nuk ka”. Ai djali i ri, shumë i vëmendshëm, thotë: Ajo ka thënë: “Nuk ka kundër. Nuk ka abstenim”, ndërkohë që zoti Karamelo nuk ka ngritur dorën.

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit zëvendësministre dhe profesoresha Hafizi!

Faleminderit për bashkëpunimin!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA